

VENDIM
Nr. 23, datë 9.2.2023

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “NATYRE ENERGY” SHPK NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, germa “d”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 4, pika 1, germa “e”, nenit 5, pika 1, germa “e”, dhe nenit 10, pikat 1 dhe 3 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe nenit 15 dhe nenit 19, pika 1, germa “a” të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 9.2.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 566/1 prot., datë 7.2.2023, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë ‘Natyre Energy’ sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Shoqëria “Natyre Energy” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 566 prot., datë 3.2.2023, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

- Në zbatim të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, aplikuesi për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike duhet të depozitojë në ERE: dokumentacionin e përgjithshëm për të gjitha aplikimet për pajisje me licencë (neni 9, pika 1); dokumentacionin specifik për licencën e tregtimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 2.5); shtojcën 1 dhe shtojcën 1/E të plotësuar; si dhe të ketë kryer pagesën për regjistrim dhe shqyrtim të aplikimit (aneksi A).

- Nga shqyrtimi i këtij aplikimi rezulton se shoqëria “Natyre Energy” sh.p.k. ka plotësuar dokumentacionin në zbatim të nenit 9 të rregullores së licencimit, për pikën 1.1, gerrat “a”, “b” dhe “c”; për pikën 1.2, gerrat “a”, “b” dhe “d”, për pikën 1.3, germën “a” dhe pikën 2.5.

- Nga ky aplikim rezulton se mungon dokumentacioni, si vijon:

Pika 1.2, “Dokumentacioni juridik dhe administrativ”:

- Germa “c”: Në kuptim të kërkesave të kësaj pike të rregullores, vihet re se shoqëria ka depozituar një strukturë të plotë sa i përket organizimit, por nuk ka bërë me dije nëse disponon stafin teknik, i cili është i punësuar apo do të punësohet në këto departamente për të ushtruar funksionet përkatëse, ndaj në vijim vlerësohet t’i kërkohej të depozitojë listën respektive.

Pika 1.3, “Dokumentacioni financiar dhe fiskal”:

- Germa “b”: Shoqëria pavarësisht statusit të Pezulluar për një periudhë të gjatë, ka detyrimin ligjor të hartojë pasqyra financiare edhe nëse rezultati është zero dhe t’i paraqesë ato në ERE për vitet 2020, 2021. Po ashtu, shoqëria duhet të paraqesë edhe bilancin kontabël për 6-mujorin e dytë për vitin 2022, (periudha kur ka qenë aktiv).

Shoqëria duhet të përcjellë në ERE edhe vendimin ortakëve të saj, në lidhje me vlerën financiare që do të vërë në dispozicion të veprimtarisë së tregtimit të energjisë elektrike, vlerë kjo e cila duhet të jetë e shoqëruar me dokumentacion vërtetues, nisur edhe nga fakti që sa më sipër llogaritet në referencë të sasive të parashikuara nga shoqëria për t’u tregtuar, rezulton se nuk mbulon asnjë muaj të ushtrimit të veprimtarisë.

- Gema “c”: Shoqëria duhet të përcjellë në ERE, planin e biznesit, sipas kësaj kërkesë të rregullores.

- Shoqëria ka kryer për llogari të ERE-s pagesën e aplikimit në zbatim të aneksit A të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar.

- Në kuadër të plotësimit nga aplikuesi të dokumentacionit thelbësor, sipas kërkesave të rregullores, vlerësohet fillimi i procedurës për këtë aplikim.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Natyre Energy” sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti